



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Zyra Ekzekutive – Komisioni i Pavarur i Mediave

RAPORT MONITORIMI

***“MONITORIMI I LAJMEVE QENDRORE TË  
OSHMA-VE”***

***DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS***

Periudha e monitorimit korrik 2021

*Prishtinë, dhjetor 2021*

## **Përmbajtja**

<b>Përkufizimet</b> .....	<b>2</b>
<b>Hyrje</b> .....	<b>3</b>
<b>I. BAZA LIGJORE</b> .....	<b>4</b>
<b>II. METODOLOGJIA</b> .....	<b>5</b>
<b>III. PREZANTIMI I GJETJEVE NGA MONITORIMI I LAJMEVEQENDRORE</b> .....	<b>8</b>
<b>Hapësira e dhënë sipas kategorive/temave të përcaktuara për monitorim</b> .....	<b>8</b>
<i>RTK1</i> .....	<b>8</b>
<i>RTK2</i> .....	<b>11</b>
<i>TV21</i> .....	<b>13</b>
<i>KTV</i> .....	<b>16</b>
<i>TV DUKAGJINI</i> .....	<b>18</b>
<i>KLAN KOSOVA</i> .....	<b>20</b>
<i>TE7</i> .....	<b>23</b>
<b>IV MBULIMI I SITUATËS PANDEMIKE NË EDICIONET E LAJMEVEQENDRORE</b> .....	<b>26</b>
<b>V PËRFUNDIM</b> .....	<b>29</b>
<b>VI. REKOMANDIM</b> .....	<b>32</b>

## Përkufizimet

- KPM – Komisioni i Pavarur i Mediave.
- DMA – Departamenti i Monitorimit dhe Analizës i Zyrës Ekzekutive të KPM-së.
- OSHMA – Ofrues i Shërbimit Medial Audio-vizuel – nënkupton personin fizik ose juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audio-vizuale të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.
- OSH – Operatori i shpërndarjes – personi juridik i cili shpërndan shërbime mediale audio dhe audio-vizuale për përdoruesit përmes rrjetit kabllor, IPTV, OTT, satelitor dhe çfarëdo forme tjetër të shpërndarjes jashtë brezit frekuencor radio-difuziv tokësor.

## Hyrje

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, KPM-ja licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio dhe audio-vizuele, përfshirë këtu edhe aspektet që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim.

Politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM-ja duhet të jetë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare të transmetimit dhe të të drejtave të njeriut.

E drejta e lirisë së mendimit dhe të shprehjes, përfshirë lirinë e mbajtjes së mendimit pa ndërhyrje dhe për të kërkuar, pranuar dhe shpërndarë informacion dhe ide përmes mediave është e drejtë e garantuar edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara si dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Duke pas parasysh rolin e mediave në përgjithësi, që krahas zhvillimeve teknologjike sot janë të qasshme për publikun përmes kanaleve të shumta të komunikimit, e në veçanti ndikimin e lajmeve në të gjitha aspektet shoqërore në përgjithësi, është e nevojshme të kemi një pasqyrë të vlerësimit të lajmeve që i plasohen publikut nga ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuele në Republikën e Kosovës.

Lidhur me këtë, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA) ka realizuar monitorimin e lajmeve qendrore të ofruara nga të licencuarit e saj gjatë muajit korrik të vitit 2021, me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të përmbajtjeve që ofrohen për qytetarët e vendit.

Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve është realizuar nga DMA-ja edhe gjatë vitit 2019<sup>1</sup> dhe 2020<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup> <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20monitorimi%20e%20lajmeveqendrore%20t%C3%AB%20OSHMA-ve%2C%20periudha%20prill-maj%202019.pdf>

<sup>2</sup> <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Shtojca%20V%20%20%20-%20Raporti%20i%20Monitorimit%20E%20%80%9CMonitorimi%20i%20lajmeve%20qendrore%20t%C3%AB%20OSHMA-ve%20E%20%80%9D.pdf>  
Komisioni i Pavarur i Mediave/Nezavisna Komisija za Medije/Independent Media Commission, Rr.Ul.Str. Perandori Justinian Nr. 124 Qyteza, Pejton, 10000 Prishtinë-Priština-Pristina/Kosovë-Kosovo, Tel: (+383) (0) 38 245 031, Fax: (+383) (0) 38 245 034, E-mail: [Info@kpm-ks.org](mailto:Info@kpm-ks.org); [www.kpm-ks.org](http://www.kpm-ks.org)

## I. BAZA LIGJORE

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, përkatësisht nenit 9, përcaktohet se:

*“Politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM-ja duhet të jetë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare të transmetimit dhe të të drejtave të njeriut, legjislacionin përkatës të BE-se e në veçanti me Direktivën e Komisionit Evropian AVMS duke respektuar plotësisht demokracinë dhe sundimin e ligjit si dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes”.*

*“Politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM-ja, duhet të reagojë në të drejtën e publikut për të ditur dhe për t’u njoftuar përmes promovimit të programeve të sakta dhe informative”.*

Sipas Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës të KPM-së, respektivisht nenit 6, përcaktohet se:

Paragrafi 1 *“OSHM-të duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t’i paraqesin ato në mënyrë të paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë material për të cilin e dinë ose duhet të dinë se është i pavërtetë ose mashtrues”.*

Paragrafi 2 *“OSHM-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërthënies politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ”.*

Paragrafi 4 *“Përderisa OSHM-të janë të lirë për të shprehur opinionet e tyre, ata duhet të bëjnë dallimin e qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit. Lajmi është informacion i përbërë nga faktet dhe të dhënat, ndërsa opinionit mbart mendimet, idetë, besimet, supozimet, komentet apo gjykimet vlerësuese”.*

Paragrafi 7 *“OSHM-të duhet të ofrojnë prezantim të perspektivave të ndryshme në mënyrë korrekte dhe të drejtë. Në qoftë se njëra palë refuzon që të ofrojë pikëpamjen e saj, publiku duhet të informohet për këtë refuzim”.*

Paragrafi 8 *“OSHM-të duhet të bazohen në burime të identifikueshme të informacionit dhe duhet të jenë të përkushtuar për të mbrojtur identitetin e atyre që japin informacion në besim, pa marrë parasysh se a kërkohet kjo paraprakisht apo jo”.*

## II. METODOLOGJIA

Me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të përmbajtjeve të ofruara përmes edicioneve informative të lajmeve qendrore është përdorur metodologjia e kombinuar, kuantitative dhe kualitative.

Fillimisht janë grumbulluar të dhënat statistikore nga subjektet e hulumtimit dhe më pas ato janë kategorizuar dhe përpunuar për arritjen e rezultateve të sakta dhe prezantimin vizual të rezultateve.

Mjetet e punës që janë shfrytëzuar për këtë monitorim janë: sistemi i monitorimit, i cili ka mundësuar qasje dhe ruajtje të përmbajtjes programore të subjekteve të këtij monitorimi, për matje, analizim edhe vlerësim.

Vlerësimi i përmbajtjeve të edicioneve qendrore të lajmeve është bërë nga zyrtarët monitorues të DMA-së, për periudhën kohore një (1) mujore, duke përfshirë muajin korrik të vitit 2021.

Mostra e monitorimit ka përfshirë shtatë (7) OSHMA, prej tyre:

- Tri (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, TV21 dhe KTV);
- Një (1) me mbulim tokësor lokal (TV DUKAGJINI); dhe
- Tri (3) që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, KLAN KOSOVA dhe TE7).

Për nxjerrjen e të dhënave sa i përket hapësirës së dhënë për kategoritë e përcaktuara është përdorur metoda kuantitative duke matur me sekonda kohën e dhënë në kronika/tema.

Përmbajtja e monitoruar është ndarë sipas kategorive/temave dhe nënkategorive në vijim:

### 1. Politikë, që ka përfshirë veprimtarinë e:

Presidentit - aktiviteti/kronika ku është i përfshirë Presidenti si protagonist (intervistë, prononcim, deklaratë e drejtpërdrejtë apo përmes komunikatave për media, rrjete sociale, vizita, takime etj.).

Presidencës - kronika që përfshinë aktivitetet e zhvilluara në kuadër të Zyrës së Presidentit, p.sh. këshilltarët, etj..

Kryeministrit - aktiviteti/kronika ku është i përfshirë Kryeministri si protagonist (intervistë, prononcim, deklaratë e drejtpërdrejtë apo përmes komunikatave për media, rrjete sociale, vizita, takime, etj.).

Qeverisë - kronika që përfshinë aktivitetet e zhvilluara në kuadër të Qeverisë në përgjithësi, p.sh. zëvendësit apo pjesëtarët e kabinetit si p.sh. këshilltarët/ apo agjenci në kuadër të Zyrës së KM-së,

Komisioni i Pavarur i Mediave/Nezavisna Komisija za Medije/Independent Media Commission, Rr.Ul.Str. Perandori Justinian Nr. 124 Qyteza, Pejton, 10000 Prishtinë-Priština-Pristina/Kosovë-Kosovo, Tel: (+383) (0) 38 245 031, Fax: (+383) (0) 38 245 034, E-mail: [Info@kpm-ks.org](mailto:Info@kpm-ks.org); [www.kpm-ks.org](http://www.kpm-ks.org)

ministritë, duke përfshirë aktivitetet në të cilën janë të përfshirë Ministri/zv. Ministri, apo pjesëtarë të kabinetit të ministrisë përkatëse.

Kryetari i Kuvendit - aktiviteti/kronika ku është i përfshirë Kryetari i Kuvendit si protagonist; (intervistë, prononcim, deklaratë e drejtpërdrejtë apo përmes komunikatave për media, rrjete sociale, vizita, takime, etj.).

Kuvendit të Kosovës - kronika që përfshinë aktivitetet (mbledhjet, takimet, vizitat etj.) e anëtarëve të Kryesisë, anëtarëve të komisioneve të Kuvendit, kronika nga seancat e Kuvendit, etj..

Subjekteve politike - aktiviteti/kronika në të cilën përfshihen aktivitetet e subjektit të caktuar politik, p.sh. konferencat për media, aktivitetet partiake, deklaratatë të drejtpërdrejta apo përmes rrjeteve sociale, intervista, etj..

Tjera - aktiviteti/kronika në të cilën përfshihen aktivitetet e institucioneve/organizatave tjera të pavarura, organizata ndërkombëtare, ambasada të Kosovës apo të vendeve të huaja, etj. në çështjet që ndërlidhen me zhvillimet politike në vend.

#### **Ekonomi/tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik:**

Çështje të përgjithshme ekonomike - lidhur me të ardhurat në nivel nacional, konsumi dhe investimet, inflacioni, GDP, çmimet, kursimet, rritja e tregut, papunësia, konkurrenca, etj..

Bujqësi - tema lidhur me bujqësi në përgjithësi.

Industri/prodhimtari - tema lidhur me industri/prodhimtari në përgjithësi.

Tjera - nënkategori të tjera të pa përfshira më sipër, që ndërlidhen me aspektin ekonomik.

#### **Kategori të tjera të sferave të caktuara, ka përfshirë fusha si:**

Drejtësi/Sundim i Ligjit - aktivitete/kronika që trajtojnë tema në fushën e drejtësisë, sundimin e ligjit në përgjithësi, respektimin e parimeve të epërsisë së ligjit, barazisë para ligjit, llogaridhënies ndaj ligjit, drejtësisë në zbatimin e ligjit, ndarjes së pushteteve, pjesëmarrjes në vendimmarrje, sigurisë juridike, etj..

Siguri - aktivitete/kronika që trajtojnë tema në fushën e sigurisë në përgjithësi (aktivitetet lidhur me mbrojtjen e territorit, qytetarëve kundër kërcënimeve për mirëqenien e tyre dhe për prosperitetin e komuniteteve të tyre (Ushtria, Policia, Zjarrfikësit, AKI dhe agjenci tjera të sigurisë), duke përfshirë zbatimin e ligjit, zjarrin, urgjencën mjekësore, ngjarjet që mund të rrezikojnë sigurinë e publikut të gjerë nga rreziqet e ndryshme, terrorizmi, dëmtimi ose dëmtimi i pronës, krimi i organizuar (përdorimi i narkotikëve, vjedhje, vrasje, etj.), komunikacion,

Komisioni i Pavarur i Mediave/Nezavisna Komisija za Medije/Independent Media Commission, Rr.Ul.Str. Perandori Justinian Nr. 124 Qyteza, Pejton, 10000 Prishtinë-Priština-Pristina/Kosovë-Kosovo, Tel: (+383) (0) 38 245 031, Fax: (+383) (0) 38 245 034, E-mail: [Info@kpm-ks.org](mailto:Info@kpm-ks.org); [www.kpm-ks.org](http://www.kpm-ks.org)

fatkeqësitë natyrore ose të shkaktuara nga faktori njeri.

Sociale - tema/kronika që trajtojnë tema shoqërore në përgjithësi. Art/Kulturë/Edukim - tema/kronika që trajtojnë tema nga arti, kultura dhe arsimi. Shëndetësi - tema/kronika që trajtojnë tema nga shëndetësia në përgjithësi.

Tjera - nënkategori të tjera të pa përfshira në nënkategoritë më sipër.

## **2. Lajmet ndërkombëtare, janë ndarë në tri nënkategori:**

Rajon - temat nga rajoni përfshirë: Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë, Bosnje Hercegovinën dhe Serbinë.

Evropë - kronika që trajtojnë tema rreth ngjarjeve në vendet evropiane.

Botë - kronika që trajtojnë tema rreth ngjarjeve në Botë (duke përfshirë Evropën).

### **Sport:**

Vendor - duke përfshirë lajme dhe kronika rreth ngjarjeve sportive në vend.

Ndërkombëtar - duke përfshirë lajme dhe kronika rreth ngjarjeve sportive në arenën ndërkombëtare.

Ndërsa, metoda kualitative është përdorur për të vlerësuar nëse lajmet e transmetuara në kronika kanë qenë relevante (mbulim i ngjarjeve/temave të kohës), janë transmetuar me saktësi (përmbajtja bazuar në informata dhe fakte të verifikuara saktë), nëse është siguruar mbulim i balancuar i çështjeve me interes publik (dy ose më shumë palë të përfshira në temën/kronikën për çështje të caktuara) si dhe është bërë vlerësimi për mënyrën e prezantimit të kronikës dhe trajtimi nga gazetari/reporteri/mediumi, përfshirë paanshmërinë në zgjedhjen e gjuhës dhe imazheve.

Sa i përket raportit gjinor, është përcaktuar që të nxirren të dhëna sasiore sa i përket numrit të moderimit/udhëheqjes dhe editimit/redaktimit të lajmeve në bazë të gjinisë si dhe hapësirës së dhënë në kategorinë e sportit sipas gjinisë. Raporti gjinor është matur edhe në prezantimin e tri kronikave të para të edicioneve qendrore, përkatësisht nëse ato janë prezantuar nga gazetarë femra apo meshkuj.



### III. PREZANTIMI I GJETJEVE NGA MONITORIMI I LAJMEVE QENDRORE


Në bazë të monitorimit të lajmeve qendrore të OSHMA-ve të përfshira në këtë raport të monitorimit, për periudhën monitoruese, në përgjithësi lajmet kanë qenë relevante dhe kanë mbuluar ngjarjet kryesore të ditës dhe kryesisht ngjarjet politike që kanë të bëjnë me vendin. Raportimet janë bazuar në burime të sakta të informacionit dhe kanë qenë të balancuara duke përfshirë dy apo më shumë palë dhe/apo burime të përfshira në ngjarjen e raportuar. Ndërkaq, sa i përket konotacionit gjatë raportimit, prezantimi në përgjithësi ka qenë neutral.

#### Hapësira e dhënë sipas kategorive/temave të përcaktuara për monitorim

Të dhënat në vijim paraqesin hapësirën e dhënë në OSHMA sipas kategorive të përcaktuara gjatë këtij monitorimi për periudhën nga data 1 deri më 31 korrik 2021.

#### RTK1

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që RTK1 ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 38.65%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 12.64%, kategori të tjera të sferave të caktuara 39.77%, lajme ndërkombëtare 6.65% dhe sport 2.29%.



## **Politikë**

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 38.65%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 1.91%
- Presidenca 0.09%
- Kryeministri 4.33%
- Qeveria 6.45%
- Kryetari i Kuvendit 0.69%
- Kuvendi 7.08%
- PDK 4.24%
- LDK 1.37%
- LVV 0.09%
- AAK 0.94%
- PSD 0.50%
- NISMA 0.00%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 10.96%.

## **Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik**

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 12.64%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 3.26%
- Bujqësi 8.43%
- Industri-prodhimtari 0.58%
- Tjera 0.37%.

## **Kategori të tjera të sferave të caktuara**

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 39.77%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 10.38%
- Siguri 4.03%
- Sociale 12.36%
- Art/Kulturë/Edukim 5.05%
- Shëndetësi 6.67%
- Tjera 1.28%.

## Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 6.65%, prej tyre:

- Rajon 2.34% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike në: Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Kroaci, Bosnje Hercegovinë e Mal të Zi.
- Evropë 1.52% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Gjermani, Francë, Britani e Madhe, Turqi dhe Norvegji.
- Botë 2.79% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Bangladesh, Irak, SHBA, Kinë, Arabi Saudite, Afganistan dhe Australi.

## Sport

Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (2.29% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit vendor i është kushtuar hapësirë prej 2.06%, ndërsa atij ndërkombëtar 0.23%.

### Raporti gjinor në prezantim dhe redaktim të lajmeve si dhe sportit në edicione të lajmeve

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 58.62% nga meshkujt kurse 41.38% nga femrat, ndërsa redaktimi i lajmeve është bërë 100% nga meshkujt.


Ndërsa, raporti gjinor sipas prezantimit në tri (3) kronikat e para të lajmeve është si në vijim:

Kronika I:	51.72% (M)	48.28% (F)
Kronika II:	44.83% (M)	55.17% (F)
Kronika III:	24.14% (M)	75.86% (F)

Sa i përket hapësirës së sportit dedikuar në lajme (2.29% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për meshkuj i është kushtuar hapësirë prej 41.33%, ndërsa për femra 58.67%.

## RTK2

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që RTK2 i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 20.30%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 3.13%, kategori të tjera të sferave të caktuara 55.48%, lajme ndërkombëtare 14.21% dhe sport 6.88%.



### Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 20.30%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 0.90%
- Presidenca 0.07%
- Kryeministri 1.52%
- Qeveria 3.26%
- Kryetari i Kuvendit 0.0%
- Kuvendi 2.97%
- PDK 0.39%
- LDK 0.47%
- LVV 0.56%
- AAK 0.17 %
- PSD 0.05%
- NISMA 0.00%

- Lista Serbe 0.84%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 9.10%.

### **Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik**

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 3.13%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 0.53%
- Bujqësi 2.38%
- Industri-prodhimtari 0.00%
- Tjera 0.22%.

### **Kategori të tjera të sferave të caktuara**

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 55.48%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 3.75%
- Siguri 4.99%
- Sociale 1.94%
- Art/Kulturë/Edukim 2.50%
- Shëndetësi 5.98%
- Tjera 36.32%.

### **Lajme ndërkombëtare**

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 14.21%, prej tyre:

- Rajon 4.36% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike në: Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi dhe Shqipëri.
- Evropë 4.26% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Gjermani, Austri, Itali, Greqi, Kroaci, Portugali, Britani e Madhe, Rusi, Luksemburg, Slloveni, Holandë, Spanjë, Qipro, Belgjikë, Ukrainë, Norvegji dhe Irlandë.
- Botë 5.59% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Amerikë, Australi, Koreja e Jugut, Afganistan, Indonezi, Tunizi, Japoni, Etiopi, Filipine, Kuba, Iran, Venezuela, Haiti, Libia, Somalia Izrael, Kanada, Tailandë, Arabi Saudite, Malajzi dhe Egjipt.

### **Sport**

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej tyre 6.88% duke përfshirë sportin vendor 2.33% dhe atë ndërkombëtar 4.55%.

## Raporti gjinor në redaktim dhe prezantim të lajmeve, në tri kronikat e para si dhe në hapësirën e sportit

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 67.74% nga femrat, kurse 32.26% nga meshkujt. Ndërkaq, redaktimi i lajmeve është bërë 50% nga femrat dhe 50% nga meshkujt.


Ndërsa, raporti gjinor sipas prezantimit në tri (3) kronikat e para të lajmeve është si në vijim:

Kronika I:	30.56% (M)	69.44% (F)
Kronika II:	40.63% (M)	59.37% (F)
Kronika III:	35.29% (M)	64.71% (F)

Sa i përket hapësirës së sportit dedikuar në lajme (6.88% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 25.48%, kurse për meshkuj 75.52%.

## TV21

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që TV 21 i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 31.67%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 7.00%, kategori të tjera të sferave të caktuara 41.88%, lajme ndërkombëtare 8.61% dhe sport 10.84%.



## **Politikë**

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 31.67%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 0.49%
- Presidenca 0.00%
- Kryeministri 2.07%
- Qeveria 3.04%
- Kryetari i Kuvendit 0.66%
- Kuvendi 7.89%
- PDK 1.86%
- LDK 1.15%
- LVV 0.27%
- AAK 0.72%
- PSD 1.26%
- NISMA 0.00%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 12.26%.

## **Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik**

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 7.00%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 3.80%
- Bujqësi 2.02%
- Industri-prodhimtari 0.00%
- Tjera 1.18%.

## **Kategori të tjera të sferave të caktuara**

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 41.88%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 5.16%
- Siguri 6.55%
- Sociale 16.68%
- Art/Kulturë/Edukim 3.94%
- Shëndetësi 7.38%
- Tjera 2.17%.

## Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 8.61%, prej tyre:

- Rajon 1.15% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike në: Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Kroaci, Bosnje Hercegovinë e Mal të Zi.
- Evropë 3.10% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Gjermani, Francë, Britani e Madhe dhe Turqi.
- Botë 4.36% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: SHBA, Kinë, Arabi Saudite, Afrike e Jugut, Izrael e Afganistan.

## Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 10.84%, prej tyre 3.92% vendor dhe 6.92% ndërkombëtar.

### Raporti gjinor në prezantim dhe redaktim të lajmeve si dhe sportit në edicione të lajmeve

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 32.26% nga meshkujt kurse 67.74% nga femrat. Ndërkaq, redaktimi i lajmeve është bërë 100% nga meshkujt.

Ndërsa, raporti gjinor sipas prezantimit në tri (3) kronikat e para të lajmeve është si në vijim:


Kronika I:	25.81% (M)	74.19% (F)
Kronika II:	16.13 % (M)	83.87% (F)
Kronika III:	19.35 % (M)	80.65 % (F)

Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (10.84% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 26.06%, ndërsa për meshkuj 73.94%.



## KTV

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezultojnë se kjo është hapësira që KTV i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 37.00%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 2.31%, kategori të tjera të sferave të caktuara 45.24%, lajme ndërkombëtare 12.91% dhe sport 2.54%. Në monitorim nuk janë përfshirë vetëm të dhënat për datën 24 korrik 2021, për shkak që nuk ka pasur incizim në sistem të monitorimit për këtë datë.



## Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 37.00 %, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 1.70%
- Presidenca 0.68%
- Kryeministri 4.15%
- Qeveria 9.80%
- Kryetari i Kuvendit 0.49%
- Kuvendi 6.50%
- PDK 3.26%
- LDK 1.32%
- LVV 1.05%
- AAK 0.73 %
- PSD 0.96%
- NISMA 0.00%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 6.36%.

## **Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik**

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 2.31 %, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 1.44%
- Bujqësi 0.59%
- Industri-prodhimtari 0.28%
- Tjera 0.00%.

## **Kategori të tjera të sferave të caktuara**

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 45.24 %, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 12.32%
- Siguri 2.61%
- Sociale 8.24%
- Art/Kulturë/Edukim 3.77%
- Shëndetësi 9.82%
- Tjera 8.48%

## **Lajmet ndërkombëtare**

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 12.91%, prej tyre:

- Rajon 0.75% - Lajmet raporti Kosovë-Serbi ka dominuar nga rajoni, pastaj diskriminimi i shqiptarëve nga Serbia, njohja e Kosovë si shtet pavarur nga deputetet shqiptar e boshnjak nga parlamenti i Serbisë, kriza politike në Bosnjë dhe Hercegovinë lidhur me futjen në legjislacion për njohjen e gjenocidit, reagime nga Tirana për helmimet në Deçan etj.
- Evropë 3.70% - Lajmet më të shpeshta kanë qenë nga përmblytjet në Evropë, Gjermani e Austri, gjithashtu edhe përhapja e zjarreve në Itali, Greqi dhe Turqi, keqtrajtimi nga rojet i të burgosurve në Itali, zgjedhjet në Bullgari, ligji kundër LGBT përplasjet e Hungarisë me BE etj..
- Botë 8.46 % - Në lajmet nga bota kanë dominuar lajmet e krizës në Afganistan pra, vendimi i Biden për tërheqjen e trupave ushtarake atje, interesimi i Kinës dhe Rusisë për krizën në Afganistan, raportet Kinë-SHBA, kriza në Haiti pas vrasjes së Presidentit, përndjekja e gazetares iraniane, për shtypjen e gazetarëve dhe shoqërisë civile, tragjedia me zjarre në një fabrikë në Bangladesh, skandali me vaksinat në Indi etj..

## Sport

Lajme nga sporti i janë dedikuar vetëm atij vendor në hapësirë prej 2.54%, ndërkaq nga ai ndërkombëtar nuk ka pasur.

### Raporti gjinor në prezantim dhe redaktim të lajmeve si dhe sportit në edicione të lajmeve

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 10% nga meshkujt kurse 90% nga femrat. Ndërkaq, redaktimi i lajmeve është bërë 50% nga meshkujt dhe 50% nga femrat.


Ndërsa, raporti gjinor sipas prezantimit në tri (3) kronikat e para të lajmeve është si në vijim:

Kronika I:	43.33% (M)	56.67% (F)
Kronika II:	26.67% (M)	73.33% (F)
Kronika III:	30.00% (M)	70.00% (F)

Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (10.84% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 74.47%, ndërsa për meshkuj 27.53%.

## TV DUKAGJINI

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit, TV Dukagjinit i është dhënë kjo hapësirë për kategoritë e mëposhtme: politikë 46.35%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 3.80%, kategori të tjera të sferave të caktuara 37.24%, lajme ndërkombëtare 0.24% dhe sport 12.37%.



## **Politikë**

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për kategori ka qenë në sasi prej 46.35%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 1.12%
- Presidenca 0.34%
- Kryeministri 2.92%
- Qeveria 4.90%
- Kryetari i Kuvendit 0.28%
- Kuvendi 7.49%
- PDK 1.80%
- LDK 2.78%
- VV 6.59%
- AAK 2.54%
- PSD 3.29%
- Nisma 0.00%
- Tjera 12.3% - përfshirë tema lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend dhe në komuna të caktuara të Kosovës.

## **Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik**

Sa i përket ekonomisë dhe çështjet që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve është dhënë hapësira prej 3.80%.

- Çështjet e përgjithshme Ekonomike 2.32%
- Bujqësi 0.00%
- Industri/Prodhimtari 1.48%
- Tjera 0.00%

## **Kategori të tjera të sferave të caktuara**

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 37.24%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 14.60%
- Siguri 3.80%
- Sociale 4.56%
- Art/Kulturë/Edukim 2.00%
- Shëndetësi 6.33%

- Të tjera 5.95% - është raportuar lidhur me aksidentin ne Kroaci ku shumë bashkatdhetarë kanë humbur jetën. TV Dukagjini ka raportuar për familjarët e tyre gjendjen e tyre fizike e psikike dhe gjithashtu këtë ngjarje e ka përcjellë nëpër komunat ku personat janë varrosur.

### **Lajme ndërkombëtare**

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 0.24%, prej tyre:

- Rajon 0.06% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, Samitin e Prespës dhe takimin Vuçiq-Zajev- Rama.
- Evropë 0.09% - lajm rreth nismës së Stokholmit për armë bërthamore.
- Botë 0.09% - ka përfshirë temë rreth zhdukjes së një avioni rus në Azi.

### **Sport**

Edicioni i lajmeve qendrore ka përfshirë edhe pjesën sportive. Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 12.37%. Në përgjithësi, sportit vendor i është kushtuar hapësirë prej 7.81%, ndërsa atij ndërkombëtar 4.56%.

### **Raporti gjinor në prezantim dhe redaktim të lajmeve si dhe sportit në edicione të lajmeve**

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë nga prezantues femra 35.48% dhe meshkuj 64.52%, ndërsa sa i përket redaktimit, nuk ka pasur informata përfundimtare.

Kronika I:	67.74% (M)	32.26% (F)
Kronika II:	71.87% (M)	28.13% (F)
Kronika III:	61.29% (M)	38.71% (F)

Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (12.37% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 27.78%, ndërsa për meshkuj 72.22%.

### **KLAN KOSOVA**

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që KLAN KOSOVA i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 37.61%, ekonomi dhe tema tjera që ndërliken me zhvillimin ekonomik 6.27%, kategori të tjera të sferave të caktuara 42.82%, lajme ndërkombëtare 9.52% dhe sport 3.78%.



## Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 37.61%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 2.05%
- Presidenca 0.14%
- Kryeministri 5.26%
- Qeveria 5.46%
- Kryetari i Kuvendit 0.53%
- Kuvendi 4.45%
- PDK 3.67%
- LDK 2.20%
- LVV 0.73%
- AAK 0.43%
- PSD 0.19%
- NISMA 0.02%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 12.48%.

## Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 6.27%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 2.87%
- Bujqësi 0.50%

- Industri-prodhimtari 0.33%
- Tjera 2.57%.

### **Kategori të tjera të sferave të caktuara**

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 42.82%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 6.39%
- Siguri 11.82%
- Sociale 4.35%
- Art/Kulturë/Edukim 4.78%
- Shëndetësi 5.07%
- Tjera 10.41%.

### **Lajme ndërkombëtare**

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 9.52%, prej tyre:

- Rajon 3.60% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Kroaci, Bosnje e Hercegovinë dhe Mal të Zi.
- Evropë 2.97% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Gjermani, Francë, Hungari dhe Belgjikë.
- Botë 2.95% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Amerikë, Australi, Kinë, Tokio, Guineja, Irak, Arabia Saudite dhe Peru.

### **Sport**

Në kuadër të edicioneve të lajmeve sportit i është kushtuar hapësirë prej 3.78%, prej tyre temave për sportin vendor 2.76% dhe sportin ndërkombëtar 1.02%.

### **Raporti gjinor në prezantim dhe redaktim të lajmeve si dhe sportit në edicione të lajmeve**


Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 52.00% nga meshkujt kurse 48.00% nga femrat, ndërsa redaktimi i lajmeve është bërë 100% nga meshkujt.

Kronika I:	48.15% (M)	51.85% (F)
Kronika II:	28.57% (M)	71.43% (F)
Kronika III:	40.74% (M)	59.26% (F)

Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (3.78% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 37.43%, ndërsa për meshkuj 62.57%.

## TE7

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që TE7 i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 31.21%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 5.01%, kategori të tjera të sferave të caktuara 56.64%, lajme ndërkombëtare 4.63% dhe sport 2.51%.



### Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 31.21%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 0.74%
- Presidenca 0.06%
- Kryeministri 5.77%
- Qeveria 6.17%
- Kryetari i Kuvendit 0.99%
- Kuvendi 6.18%
- PDK 6.84%
- LDK 0.35%
- LVV 0.73%
- AAK 0.10%
- PSD 1.38%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 1.90%.



## **Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik**

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 5.01%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 2.18%
- Bujqësi 0.76%
- Industri-prodhimtari 0.81%
- Tjera 1.26%.

## **Kategori të tjera të sferave të caktuara**

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 56.64%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 11.23%
- Siguri 9.27%
- Sociale 9.48%
- Art/Kulturë/Edukim 3.79%
- Shëndetësi 12.40%
- Tjera 10.47%.

## **Lajme ndërkombëtare**

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 4.63%, prej tyre:

- Rajon 0.45% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Maqedoninë e Veriut, Serbi e Mal të Zi.
- Evropë 0.74% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Britani e Madhe, Francë, Belgjikë, Itali, Gjermani,
- Botë 3.44% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: SHBA, Japoni, Kinë dhe Kore e Veriut.

## **Sport**

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 2.51% dhe vetëm atij vendor.

## **Raporti gjinor në redaktim dhe prezantim të lajmeve, në tri kronikat e para si dhe në hapësirën e sportit**

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 81.48% nga femrat kurse 18.52%

nga meshkujt. Ndërkaq, redaktimi i lajmeve është bërë 100% nga meshkujt.

Ndërsa, raporti gjinor sipas prezantimit në tri (3) kronikat e para të lajmeve është si në vijim:

Kronika I:	57.69% (M)	42.31% (F)
Kronika II:	44.44% (M)	55.56% (F)
Kronika III:	37.04% (M)	62.96% (F)

Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (2.51% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 72.47%, ndërsa për meshkuj hapësirë prej 27.53%.

## IV MBULIMI I SITUATËS PANDEMIKE NË EDICIONET E LAJMEVE QENDRORE

Fokus i monitorimit gjatë periudhës së muajit korrik 2021, ishte edhe mbulueshmëria e situatës pandemike në edicionet e lajmeve qendrore. Gjatë kësaj periudhe është matur hapësira e dhënë në kronikat që kanë trajtuar temën e COVID19, e ndërlidhur me fushat dhe ndikimit në këto fusha si në vijim: Ekonomi, Shëndetësi, Siguri, Sociale, Sport dhe Kulturë, Raportimi rreth situatës jashtë Kosovës dhe të tjera.

**RTK1** - gjatë periudhës monitoruese në edicionet e lajmeve qendrore janë transmetuar kronika që kishin të bëjnë me situatën pandemike në vendin tonë rreth 8.60% e totalit të lajmeve. Kjo përqindje e ndarë në fusha të caktuara është si vijon:

- Ekonomi 0.00%
- Shëndetësi 31.51%
- Siguri 0.84%
- Sociale 12.88%
- Sport dhe Kulturë 0.00%
- Raportimi rreth situatës jashtë Kosovës 4.77%
- Të tjera 50%

**RTK2** - gjatë periudhës monitoruese në edicionet e lajmeve qendrore janë transmetuar kronika që kishin të bëjnë me situatën pandemike në vendin tonë rreth 15.99% e totalit të lajmeve. Kjo përqindje e ndarë në fusha të caktuara është si vijon:

- Ekonomi 0.00%
- Shëndetësi 21.14%
- Siguri 0.00%
- Sociale 0.00%
- Sport dhe Kulturë 0.00%
- Raportimi rreth situatës jashtë Kosovës 28.86%
- Të tjera 50%

**TV21** - gjatë periudhës monitoruese në edicionet e lajmeve qendrore janë transmetuar kronika që kishin të bëjnë me situatën pandemike në vendin tonë rreth 1.21% e totalit të lajmeve. Kjo përqindje e ndarë në fusha të caktuara është si vijon:

- Ekonomi 0.00%
- Shëndetësi 49.58%
- Siguri 0.00%
- Sociale 0.00%

- Sport dhe Kulturë 0.00%
- Raportimi rreth situatës jashtë Kosovës 19.39%
- Të tjera 31.03%

**KTV** - gjatë periudhës monitoruese në edicionet e lajmeve qendrore janë transmetuar kronika që kishin të bëjnë me situatën pandemike në vendin tonë rreth 20.87% e totalit të lajmeve. Kjo përqindje e ndarë në fusha të caktuara është si vijon:

- Ekonomi 0.00%
- Shëndetësi 24.35%
- Siguri 3.30%
- Sociale 9.05%
- Sport dhe Kulturë 0.00%
- Raportimi rreth situatës jashtë Kosovës 13.30%
- Të tjera 50.00%

**TV Dukagjini** - gjatë periudhës monitoruese në edicionet e lajmeve qendrore janë transmetuar kronika që kishin të bëjnë me situatën pandemike në vendin tonë rreth 10.95% e totalit të lajmeve. Kjo përqindje e ndarë në fusha të caktuara është si vijon:


- Ekonomi 9.34%
- Shëndetësi 33.85%
- Siguri 1.67%
- Sociale 5.14%
- Sport dhe Kulturë 0.00%
- Raportimi rreth situatës jashtë Kosovës 0.00%
- Të tjera 50.00%

**Klan Kosova** - gjatë periudhës monitoruese në edicionet e lajmeve qendrore janë transmetuar kronika që kishin të bëjnë me situatën pandemike në vendin tonë rreth 3.26% e totalit të lajmeve. Kjo përqindje e ndarë në fusha të caktuara është si vijon:

- Ekonomi 85.02%
- Shëndetësi 0.00%
- Siguri 0.00%
- Sociale 0.00%
- Sport dhe Kulturë 0.00%
- Raportimi rreth situatës jashtë Kosovës 7.33%
- Të tjera 7.65%


**TE7** - gjatë periudhës monitoruese në edicionet e lajmeve qendrore janë transmetuar kronika që kishin të bëjnë me situatën pandemike në vendin tonë rreth 13.48% e totalit të lajmeve. Kjo përqindje e ndarë në fusha të caktuara është si vijon:

- Ekonomi 0.78%
- Shëndetësi 38.00%
- Siguri 4.15%
- Sociale 0.00%
- Sport dhe Kulturë 0.00%
- Raportimi rreth situatës jashtë Kosovës 7.07%
- Të tjera 50.00%



## V PËRFUNDIM


Nga të dhënat dhe rezultatet e monitorimit është gjetur se nga koha e përgjithshme e lajmeve (prej 399239 sekonda), OSHMA-të e monitoruara në periudhën e muajit korrik 2021, në edicionet qendrore informative në përgjithësi i kanë kushtuar hapësirë ngjarjeve politike 34.68%, ekonomisë dhe temave tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 5.74%, kategorive të tjera të sferave të caktuara 45.58%, lajmeve ndërkombëtare 8.11% dhe sportit 5.89%.



Sa i përket mbulueshmërisë së situatës pandemike gjatë muajit korrik, është gjetur se të gjitha subjektet e monitoruara, në bazë të të dhënave të sipërpërmendura, i kanë kushtuar hapësirë prej 10.35% të lajmeve temave që ndërlidhen me COVID19 dhe ndikimit në fusha të ndryshme shoqërore, prej tyre: Ekonomi 13.59%, Shëndetësi 28.35%, Siguri 1.42%, Sociale 3.87%, Sport dhe Kulturë 0.00%, Raportimi rreth situatës jashtë Kosovës 11.53% dhe kategorisë Të tjera 41.24%.

Në lidhje me raportin gjinor, në bazë të monitorimit janë nxjerr të dhëna sa i përket raportit gjinor në prezantim dhe redaktim të lajmeve, në tri kronikat e para si dhe në hapësirën e sportit.

Në periudhën e monitoruar, nga data 1 deri më 31 korrik 2021, prezantimi i lajmeve është bërë nga prezantuese femra prej 61.69% kurse nga prezantues meshkuj 38.31%, ndërsa redaktimi i lajmeve është bërë nga meshkujt 83.33% kurse nga femrat 16.67%.




Ndërsa, sa i përket tri kronikave të para të lajmeve, është ofruar kjo hapësirë:


Kronika I: 46.43% (M) 53.57% (F)

Kronika II: 39.02% (M) 60.98% (F)

Kronika III: 35.41% (M) 64.59% (F)



Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (5.89% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 45.77%, ndërsa për meshkuj hapësirë prej 54.23%.





## VI. REKOMANDIM

Në bazë të të dhënave të gjetura nga monitorimi dy mujor i lajmeve qendrore të OSHMA-ve, për periudhën prej datës 1 deri më 31 korrik 2021, KPM rekomandon që:

- Të licencuarit duhet të angazhohen që publiku pranon lajme kualitative (në kuptimin e saktësisë, besueshmërisë dhe mbulimit të çështjeve relevante me interes për publikun), me qëllim të ruajtjes së kredibilitetit të medias në ofrimin e informacioneve të sakta dhe për shkak se lajmet konsiderohen burimi kryesor i informacionit që publiku pranon rreth ngjarjeve me rëndësi për ta dhe të cilat mund të ndikojnë në vendimet që ata ndërmarrin për çështje të caktuara;
- Të licencuarit duhet të angazhohen në rolin mbikëqyrës dhe kritikues të institucioneve shtetërore, sistemin e vlerave shoqërore dhe të gjitha aspektet e jetës në shoqërinë tonë duke trajtuar temat me rëndësi për publikun që i shërbejnë;
- Publiku duhet t'i kushtojë rëndësi përmbajtjes së ofruar dhe të përfshihet, angazhohet dhe luaj rol aktiv në këtë aspekt, në kuptimin e përfaqësimit, parashtrimin të kërkesave apo ankesave etj..

## **KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE**

Raporti është përpiluar nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizave, në kuadër të Zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të KPM-së, z. Faruk REXHAJ.

### **Në raport kontribuuan:**

Mirand TAFARSHIKU

Gentiana HOTI

Amela REDŽOVIĆ

Ardiana SEJDIU MUSMURATI

Bashkim REÇICA

Fikrete ÇOÇAJ

Luljeta ISLAMAJ

Sanije IMERAJ ZATRIQI

Sebahate HAJREDINAJ

### **Publikues:**

## **KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE**

**rr. Perandori Justinian nr. 124**

**10000 Prishtinë**

**Kosovë**

[www.kpm-ks.org](http://www.kpm-ks.org)

Dhjetor 2021